



QKSS

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Edicion special:

Siguria publike në Kosovë

Trendët e Perceptimeve të Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë

Periudha: 2012 – 2015



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

Edicion special:

Siguria publike në Kosovë

Trendët e Perceptimeve të Qytetarëve për Sigurinë Publike në Kosovë
Periudha: 2012 – 2015

Publisher: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Mbështetës i projektit: National Endowment for Democracy (NED)

Interpretuesja e të dhënave: Sofije Kryeziu

Shqyrtimi i brendshëm: Mentor Vrajolli dhe Florian Qehaja

Recensent: Shpend Kursani

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe pronës intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes apo të transmetohet, në asnjë formë apo me asnjë mjet elektronik, mekanik apo tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha publikimeve nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), nuk është i lejuar pa pëlqimin me shkrim të QKSS. Ju lutemi kontaktoni: info@qkss.org apo +381 38 221 420.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të grumbulluara nga respondentët dhe demonstrojnë vetëm atë sesi respondentët e perceptojnë sigurinë publike në Kosovë. Ky në asnjë mënyrë nuk është një vlerësim i përcaktuar mbi cilësinë e punës së institucioneve që i janë nënshtruar këtij studimi. Raporti do t'i shërbejë atyre si një instrument për të adresuar mangësitë e mundshme, por gjithashtu si një tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me popullin.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e respondentëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Mendimet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).

PËRMBAJTJA

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?	7
KË KEMI NË SHËNJESTËR TË KËTIJ EDICIONI SPECIAL?	7
NDIKIMI.....	7
METODOLOGJIA	8
1. HYRJE	9
2. GJETJET KYÇE:.....	10
3. SA TË SIGURT NDJEHEN QYTETARËT E KOSOVËS?	11
3.1. Analiza e perceptimeve të qytetarëve mbi sigurinë publike sipas gjinisë.....	14
3.2. Analiza krahasimore e perceptimeve të qytetarëve mbi sigurinë publike sipas zonës	16
3.3. Analiza e perceptimeve të qytetarëve mbi sigurinë publike sipas përkatësisë etnike ...	19
4. ÇËSHTJET KRYESORE TË SIGURISË PUBLIKE NË KOSOVË	22
5. OFRUESIT E SIGURISË	25
6. PËRMIRËSIMI I SIGURISË PUBLIKE	29
PUNIMET E CITUARA	32
PUBLIKIMET E MËPARSHME TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË	33
PUBLIKIMI I RADHËS I BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË	33

LISTA E FIGURAVE

Figura 1- Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?	11
Figura 2 – Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin tuaj?	12
Figura 3 – Sa të sigurt ndjeheni në Lagjen tuaj?	13
Figura 4 – Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpinë/Apartamentin tuaj?	13
Figura 5 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?	14
Figura 6 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin tuaj?	15
Figura 7 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Lagje?	15
Figura 8 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpi/Apartament?	16
Figura 9 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?	17
Figura 10 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin Tuaj?	17
Figura 11 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Lagje?	18
Figura 12 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpi/Apartament?	18
Figura 13 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?	19
Figura 14 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin tuaj?	20
Figura 15 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Lagje?	20
Figura 16 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpi/Apartament?	21
Figura 17 – Shqetësimet kryesore lidhur me sigurinë nga viti 2013 deri në vitin 2015	24
Figura 18 – Arsyet e hezitimit të qytetarëve për të bashkëpunuar me policinë	26
Figura 19 – Masat për përmirësimin e sigurisë publike	30

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një program specifik i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) i dizajnuar për të shërbyer si një publikim vjetor. Përveç gjetjeve të përgjithshme, programi boton edhe edicione speciale në lëmi të parapërcaktuara. Fokusi primar i BKS është matja e perceptimeve të publikut ndaj institucioneve të sigurisë dhe politikëbërjes. Ai poashtu mat perceptimet publike mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë së Kosovës. BKS shënon njërën nga nismat më të mëdha dhe madje të parën të dizajnuar, zbatuar dhe komunikuar nga një organizatë vendore think tank në Kosovë. QKSS nuk ka asnjë kufizim politik në komunikimin e gjetjeve dhe mesazheve. Në fund, BKS është unik në qasjen e tij metodologjike, siç është adaptimi enkas i metodave sasiore dhe cilësore me qëllim që të ofrojë rezultate realiste mbi perceptimin publik ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë.

KË KEMI NË SHËNJESTËR TË KËTJË EDICIONI SPECIAL?

Edicioni special i KSB vë në shënjestër një larmi të gjerë të aktorëve të interesuar në trendet e opinionit publik në Kosovë në fushën e sigurisë publike. Ai vë në shënjestër politikëbërësit në Kosovë si dhe në Ballkanin Perëndimor; organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe zyrat e tyre qendrore; organizatat e shoqërisë civile vendore dhe ndërkombëtare; akademinë dhe mediat.

NDIKIMI

Ndikimi i BKS mund të pritët të shumëfishohet në afat të mesëm për një varg arsyesh që, mes tjerash, përfshijnë (a) kredibilitetin e QKSS si një organizatë think tank e pavarur dhe e papërcaktuar politikisht; (b) historikun e rezultateve të QKSS në përdorimin e metodologjisë së duhur në punën e saj kërkimore; (c) rëndësinë e pronësisë vendore; dhe (d) kapacitetet profesionale në dispozicion në QKSS. Në tri edicionet e mëparshme, BKS i ka arritur katër synimet e lartpërmendura.

METODOLOGJIA

Ky edicion special i BKS ofron një përmbledhje të perceptimeve të qytetarëve ndaj sigurisë publike në Kosovë. Për më tepër, ai ofron të dhënat cilësore të mbledhura gjatë periudhës katërvjeçare: nga viti 2012 deri në vitin 2015, duke paraqitur trendet dhe modelet që dalin lidhur me sigurinë publike. Ai përqendrohet posaçërisht në shqetësimet dhe çështjet kryesore lidhur me sigurinë publike sipas respondentëve, si dhe në masat të cilat duhen ndërmarrë për përmirësimin e sigurisë publike në Kosovë. Zbërthimi i opinioneve është bazuar në angazhimin e drejtpërdrejtë të interpretuesit të të dhënave në intervistat fytyrë për fytyrë me respondentët. Gjithashtu, focus grupet me anketuesit e terrenit e kanë mbështetur ekipin e QKSS në zbërthimin dhe analizën e mëtejme të opinioneve të paraqitura në këtë edicion special.

Përgjigjet në pyetësorët e BSK janë marrë në intervista fytyrë-për-fytyrë të kryera në mbarë Kosovën. Shumica e pyetjeve kanë qenë të tipit të mbyllur në formën e shkallëve pesë-pikëshe të Likert-it. Mostrimi, pilotimi dhe intervistimi janë kryer nga ekipi i QKSS prej 35 anketues terreni. Mostra kombëtare për kryerjen e hulumtimit ka përfshirë përafërsisht 1,100 ekonomi familjare, duke ndjekur një mostrë përfaqësuese të popullatës së moshës mbi 18 vjeç në Kosovë. Zbërthimi etnik i respondentëve të intervistuar është përafërsisht si vijon: 88 përqind shqiptarë të Kosovës, 9 përqind serbë të Kosovës, dhe 3 përqind të tjerë (turq, boshnjakë, romë-ashkali-egjiptas (RAE) dhe të tjerë duke përfshirë goranët, kroatët dhe malazeztë).

Korniza e mostrës u bazua në zonat e kodeve telefonike, dhe, si e tillë, përfshiu 7 rajonet vijuese: Ferizaji, Gjakova, Gjilani, Mitrovica, Peja, Prishtina dhe Prizreni. Faza e parë e grupimit gjeografik u bazua në Raportin e regjistrimit të popullsisë në Kosovë nga viti 2012, në fazën e dytë u bë grupimi i mostrave sipas sipërfaqeve komunale me mostra të stratifikuara rurale/urbane sipas numrit të ekonomive familjare. Në fazën e fundit u ndjek metoda e rastësishme e mostrimit duke e përdorur "metodën e ditëlindjes" më të afërt. Mostrimi i rastit siguron që secili banor i Kosovës ka gjasa të barabarta të përzgjedhjes për t'u intervistuar. Margjina e gabimit është 3 përqind me interval besimi prej 95 përqind.

Para fillimit të punës në terren, në fillim të secilës anketë është kryer pilot intervista, në mënyrë që të testohet realizueshmëria e pyetësorëve. Rrjedhimisht, ekipi i punës kërkimore raportoi se pilot intervistat u treguan të suksesshme, dhe se nuk u hasën probleme me pyetjet e parashtruara të intervistuarve në pilotim. Të gjitha intervistat u kryen gjatë një periudhe prej përafërsisht 15 ditë. Përpunimi dhe analiza e të dhënave u krye duke përdorur softverin SPSS. Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e informatave të grumbulluara nga respondentët dhe demonstrojnë vetëm atë se si njerëzit e perceptojnë sigurinë publike në Kosovë. Së këndejmi, ky raport nuk paraqet vlerësim vendimtar mbi cilësinë e punës së institucioneve të sigurisë publike të cilat i janë nënshtruar këtij studimi.

1. HYRJE

Ky edicion special i Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) mat perceptimin e qytetarëve mbi sigurinë publike në Kosovë bazuar në të dhënat nga anketat të mbledhura gjatë katër viteve të fundit (nga viti 2012 deri në vitin 2015). Për më tepër, do të jepen edhe perceptimet e qytetarëve mbi një larmi çështjesh të ndryshme të sigurisë në Kosovë. Si disa prej çështjeve më urgjente lidhur me sigurinë të veçuara nga respondentët janë rreziku apo kërcënimet që rrjedhin nga aksidentet e trafikut, plaçkitjet dhe kafshët endacake. Shkalla gjer në të cilën qytetarët preken nga këto fenomene është dhënë në raport. Raporti poashtu do të paraqesë perceptimet mbi masat që duhen ndërmarrë nga ana e institucioneve të sigurisë në nivel të politikave për të përmirësuar sigurinë publike në Kosovë. Raporti gjithashtu siguron të dhëna mbi besimin e popullit dhe bashkëpunimin mes qytetarëve dhe institucioneve të sigurisë në raportimin e krimit.

Më konkretisht, ky edicion special mbulon sa vijon:

- Perceptimet e publikut sa i përket sigurisë publike në Kosovë me fokus në pjesët specifike të vendit;
- Rreziqet dhe kërcënimet kryesore në komunitet në Kosovë;
- Perceptimet publike mbi ofruesit kryesorë të sigurisë në Kosovë; dhe
- Opinionin publik mbi masat që duhen ndërmarrë në mënyrë që të përmirësohet siguria publike në Kosovë;

2. GJETJET KYÇE:

- Gjatë katër viteve, mesatarisht, 40 përqind e respondentëve janë ndjerë të sigurt, gjersa 40 përqind të tjerë nuk janë ndjerë as të sigurt as të pasigurt, përdërisa 20 përqind të mbetur janë ndjerë të pasigurt në Kosovë.
- Një trend i kufizuar pozitiv është shënuar në perceptimet mbi sigurinë e përgjithshme publike gjatë katër viteve të mbuluara në këtë raport. Rritja duket të jetë së paku tri pikë përqindjeje për vit, duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2015. Ky trend pozitiv tregon ngritje të besimit të përgjithshëm publik ndaj ofruesve kryesor të sigurisë.
- Aksidentet në trafik, plaçkitjet dhe kafshët endacake perceptohen si tri sfidat kryesore të sigurisë.
- Në katër vitet e shkuara, mesatarisht gjatë secilit vit kanë ndodhur 17,700 aksidente trafiku, rreth 10,000 njerëz janë lënduar, gjersa më shumë se 120 persona kanë humbur jetën çdo vit.
- Gratë kanë shprehur shkallë pak më të lartë të ndjenjës së sigurisë në shtëpitë/apartamentet e tyre në krahasim me burrat. Mirëpo, ato ndjehen shumë më pak të sigurta në nivel të komunitetit.
- Lagjet e banuara kryesisht nga komuniteti serb dhe ato përgjatë vijës kufitare me Serbinë (të banuara nga komuniteti shqiptar) rezultojnë që ndjehen më pak të sigurta në krahasim me rajonet e tjera të Kosovës.
- Gjersa shumica e respondentëve shprehin gatishmëri për të raportuar krimin tek policia, njëkohësisht ndjejnë frikë se policia do ta zbuloj identitetin e tyre. Kështu, ata dyshojnë në efektivitetin e agjencive për zbatimin e ligjit në trajtimin dhe luftimin e krimeve, krahas dukurive tjera negative.
- Përmirësimi i sistemit arsimor dhe zhvillimi ekonomik janë identifikuar nga më shumë se 90 përqind të respondentëve si dy masat parësore të cilat do të ndihmonin në përmirësimin e shkallës së sigurisë publike në Kosovë.
- Në radhët e respondentëve vërehet mungesë serioze e vetëdijes lidhur me dhunën në familje, posaçërisht kur kemi të bëjmë me format e ndryshme të manifestimit të saj. Respondentët ngurruan të përgjegjen drejt mbi dhunën në familje si dhe në rastet e ngjashme të pyetjeve të tjera të ndjeshme.


3. SA TË SIGURT NDJEHEN QYTETARËT E KOSOVËS?

Nga viti 2012 deri në fund të vitit 2015, përqindja e respondentëve që ndjehen të sigurt në Kosovë është rritur gradualisht. Në vitin 2012 nga respondentët u kërkua që të vlerësojnë sigurinë publike në Kosovë. Në tri vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2015), përveç vlerësimit të kësaj çështjeje në nivel kombëtar, nga respondentët u kërkua që të vlerësojnë shkallën gjer në të cilën ata ndjehen të sigurt në zona tjera specifike gjeografike. Në këtë kuptim, perceptimet e qytetarëve mbi sigurinë personale u vrojtuan në katër nivele të ndryshme. Këto përfshijnë sigurinë personale në (i) nivel kombëtar – Kosovë, (ii) në qytetin apo fshatin e tyre varësisht nga vendndodhja e respondentëve, (iii) në lagjen e tyre, dhe në fund (iv) në shtëpinë apo apartamentin ku ata jetojnë. Nga rezultatet e grumbulluara në tri vitet e fundit, vërehet se ka dallime sa i përket sigurisë personale të respondentëve dhe këto varen shumë nga vendndodhja e tyre. Në përgjithësi, respondentët ndjehen më të sigurt në hapësirat e njohura për ta, që nënkupton se shumica prej tyre ndjehen të sigurt në shtëpitë/apartamentet e tyre përderisa ndjenja e sigurisë bie sa më larg nga shtëpia që ata të jenë.

Rezultatet e tri viteve të fundit tregojnë se ekziston një trend pozitiv sa i përket perceptimeve mbi sigurinë publike në radhët e respondentëve në nivel kombëtar. Një trend pozitiv i palëkundur sa i përket sigurisë publike u shënuar mes viteve 2012, 2013 dhe 2014, ku në radhët e respondentëve u shënuar një rritje prej 12 pikë përqindjeje mbi ndjenjën e sigurisë. Nga ana tjetër, mes viteve 2014 dhe 2015 u vërejt ndryshim konsiderueshëm më i vogël, ku ky ndryshim ka rënë në vetëm një çerek (nga 12 në 3 përqind) të vlerës së trendit pararendës.

Kjo tkurrje e trendit pozitiv është ndikuar negativisht nga jostabiliteti politik i pranishëm gjatë viteve 2014 dhe 2015. Ndonëse këto ngjarje u përqendruan kryesisht në kryeqytet, ato kanë ndikuar në perceptimet mbi sigurinë publike anekënd territorit të Kosovës. Për më tepër, në fund të vitit 2015, 90 përqind e respondentëve vlerësuan jostabilitetin dhe ngërçin politik si rrezik ndaj sigurisë së përgjithshme në Kosovë.¹

Figura 1 - Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?




1 Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i pestë, Dhjetor 2015

Ndonëse u shënuar trend pozitiv, duke filluar nga viti 2012, perceptimet e përgjithshme vjetore ishin kryesisht negative. Më 2012, 46 përqind të respondentëve nuk ndjeheshin plotësisht të sigurt, që nënkupton se ata e vlerësonin sigurinë publike në Kosovë në një nivel mesatar. Një pjesë tjetër e respondentëve prej 29 përqind vlerësuan sigurinë publike si kryesisht të keqe, në krahasim me vetëm 24 prej tyre të cilët mendonin se siguria publike në Kosovë mund të konsiderohet të jetë e nivelit të mirë. Ngjashëm, më 2013 rreth 42 përqind janë shprehur se nuk ndjehen as të sigurt as të pasigurt në Kosovë, gjersa pothuajse një çerek i respondentëve janë ndjerë kryesisht të pasigurt. Vetëm me ardhjen e vitit 2014 u shënuar rezultate të cilat tregojnë trend pozitiv në perceptimin publik mbi sigurinë, që nënkupton se shumica u zhvendos në grupin e atyre që ndjehen kryesisht të sigurt. Sidoqoftë, përkundër këtij trendi pozitiv, një përqindje e konsiderueshme e respondentëve janë ndjerë as të sigurt as të pasigurt.

Në përgjithësi, vërehet një nivel i konsiderueshëm i pasigurisë dhe mungesa e besimit ndaj institucioneve – sektorit gjyqësor dhe institucioneve të sigurisë, (për këto të fundit në shkallë pak më të vogël).² Ekziston nevojë serioze që të ndërmerren disa hapa të caktuar në trajtimin e çështjeve të sigurisë publike. Institucionet shtetërore duhet të bëjnë përpjekje për ta fituar besimin e publikut, në mënyrë që të lehtësojnë dhe forcojnë tutje bashkëpunimin mes qytetarëve dhe institucioneve të sigurisë me qëllim që të luftohen krimet e ndryshme që ndikojnë negativisht në sigurinë publike.

Në rastet kur krahasohet siguria në nivel kombëtar me sigurinë në nivel të komunitetit, perceptimet për këtë të fundit janë kryesisht më pozitive. Shumica e respondentëve, 68 përqind më 2013, 75 përqind më 2014 dhe 78 përqind më 2015 ndjehen të sigurt në fshatin/qytetin e tyre.


Figura 2 – Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin tuaj?



² Për më shumë hollësi, ju lutemi të shihni Barometrin Kosovar të Sigurisë, edicionet vjetore për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2015


Perceptime të ngjashme pozitive mbi sigurinë publike dalin në pah kur bëhet analiza në nivel të lagjes. Për tri vitet e fundit, mesatarisht 81 përqind e respondentëve ndjehen kryesisht të sigurt në lagjet e tyre. Ky perceptim i sigurisë mund të shpjegohet me faktin se njerëzit që jetojnë në këto vende janë më mirë të njohur për njëri-tjetrin, e njohin njëri-tjetrin dhe zakonisht nuk kanë përjetuar gjëra që ndërlidhen me krimin e rëndë. Siç shihet në figurën e mëposhtme, këto përqindje janë rritur në dy vitet e fundit për një minimum prej 5 pikë përqindjeje të dyja rastet (si për lagje ashtu edhe për shtëpi/apartamente).

Figura 3 – Sa të sigurt ndjeheni në Lagjen tuaj?



Kur kemi të bëjme me sigurinë personale në shtëpinë/apartamentin e vet, shumica e qytetarëve janë ndjerë mjaft të sigurt gjatë periudhës trivjeçare që mbulon vitet 2013-2015. Siç tregon figura e mëposhtme, shumica e respondentëve janë ndjerë mesatarisht të sigurt në shtëpinë/apartamentin e tyre (rreth 82 përqind).

Figura 4 – Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpinë/Apartamentin tuaj?




3.1. Analiza e perceptimeve të qytetarëve mbi sigurinë publike sipas gjinisë

Shikuar nga pikëpamja gjinore, mund të vërehen disa dallime në rezultate të cilat në esencë gërshetohen me natyrën e dallimeve ekzistuese gjinore. Perceptimet shkaktohen nga një varg faktorësh mbizotërues në shoqërinë e Kosovës. Këto perceptime burojnë nga fakti se gratë, në shkallë shumë më të madhe se burrat, kanë qenë viktime të ngacmimeve, llojeve të ndryshme të krimit siç është vjedhja nga xhepi, si dhe formave tjera të cenimit të integritetit trupor në përgjithësi. Si pasojë, në krahasim me burrat, pritjet për sigurinë personale janë të larta në radhët e grave. Përkatësisht, shpesh agjencitë e zbatimit të ligjit kanë dështuar në adresimin adekuat të dhunës ndaj grave që ka rezultuar me raste të shpeshta ku kryesit kanë shpëtuar pa u ndëshkuar.

Të dhënat për vitin 2012 sugjerojnë se gratë janë pak më të brengosura mbi sigurinë publike sesa burrat. Rreth 33 përqind të grave e perceptuan sigurinë publike në Kosovë si të keqe, gjersa 29 përqind e burrave e perceptuan po në këtë mënyrë. Kjo krijon një hendek të sigurisë mes gjinive prej të paktën 4 përqind e pikëve. Ngjashëm, ishin vetëm 20 përqind e grave, në krahasim me 26 përqind e burrave, që perceptuan sigurinë publike në Kosovë si të mirë. Numrat për të dy, gratë dhe burrat që perceptuan sigurinë publike si të një niveli mesatar janë të ngjashëm, - rreth 45 përqind në të dy rastet. Në vitet në vijim shihet një rritje në perceptimin pozitiv nga të dy gjinitë, edhe pse përqindja e grave të cilat ndjehen kryesisht të sigurta është edhe më tutje më pak se 50 përqind gjer në përfundim të vitit 2015.


Figura 5 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?



Rezultatet janë më pozitive në të dy rastet kur të krahasohen dallimet gjinore në nivel të komunitetit, gjë që mund të pritët duke marrë parasysh rritjen e trendeve në nivelin agregat. Nuk ka dallime të konsiderueshme mes burrave dhe grave që ndjehen të sigurt në fshatin/qytetin ku jetojnë. Më 2015, respondentët nga të dy gjinitë në


shkallë të barabartë u shprehën se ndjehen të sigurt, me 78 që ndjehen të sigurt në komunitetin e tyre.

Figura 6 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin tuaj?



Rezultatet janë të ngjashme kur këto të dhëna shqyrtohen në nivel të lagjes. Ndonëse është vërejtur se gratë ndjehen pak më të sigurta në lagjet e tyre përkatëse në krahasim me burrat. Mirëpo, ndryshimi është relativisht i ulët dhe nuk paraqet rritje të perceptimit të sigurisë në radhët e grave.


Figura 7 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Lagje?



Dallimet janë edhe më të shprehura kur është parashtruar pyetja sa të sigurt ndjehen në shtëpinë/apartamentin e tyre. Është e evidente se gratë në përgjithësi ndjehen më të sigurta në shtëpi/apartament në krahasim me burrat. Kjo mund të jetë si rrjedhojë e mendësisë konservatore e cila ende ekziston mesatarisht në familjet e Kosovës, ku gratë zakonisht janë të prirura të besojnë se burrat do t'i mbrojnë (do t'i bëjnë të


ndjehen të sigurta) në hapësirën ku jetojnë. Rezultate të ngjashme janë shënuar në vitet 2014 dhe 2015, ku gratë vazhdonin të ndiheshin kryesisht të sigurta në shtëpitë/apartamentet e tyre.

Figura 8 – Gjinia: Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpi/Apartament?




3.2. Analiza krahasimore e perceptimeve të qytetarëve mbi sigurinë publike sipas zonës

Dallimet në perceptime mes qytetarëve që jetojnë në zona urbane dhe rurale janë minimale. Të dhënat në vitin 2012 sugjerojnë se 32 përqind të qytetarëve që jetojnë në zona urbane, në krahasim me 27 përqind që jetojnë në zona rurale, duket se janë më të brengosur mbi sigurinë publike. Perceptimet janë rezultat i vetëdijes më të madhe mbi çështjet e sigurisë publike në radhët e respondentëve që jetojnë në zonat urbane në krahasim me ata që jetojnë në zonat rurale. Mirëpo, nuk ka edhe aq shumë dallime kur jepen informata kthyesive pozitive mbi sigurinë publike. Të dy tërësitë e respondentëve, ata që jetojnë në zona urbane dhe rurale, e perceptojnë sigurinë publike si të një niveli mesatar dhe vetëm 24 përqind nga secila tërësi, mendojnë se siguria publike është përgjithësisht e një niveli të mirë. Gjersa në tri vitet vijuese (2013, 2014 dhe 2015), rezultatet kanë qenë pak a shumë të njëjta, kurse në vitin 2015, respondentët në zonat urbane janë ndjerë kryesisht më të sigurtë sesa ata në zonat rurale. Kjo mund të jetë si rezultat i pranisë më të madhe të ofruesve të sigurisë dhe qasjes më të lehtë ndaj tyre në zonat urbane.


Figura 9 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?

Shikuar nga pikëpamja e komunitetit, respondentët në zonat rurale kanë shprehur shqetësimet e tyre se në rrugë ka pak ose aspak prani të policëve, gjë që krijon një mjedis tolerant për kundërvajtje dhe krime të llojeve të ndryshme. Njëlloj, duket se respondentët në zonat rurale e kuptojnë se në rast aksidenti, vrasjeje në tentativë, plaçkitjeje apo veprave të ngjashme, autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe sigurisë i duhet më shumë kohë për të arritur në vendin e ngjarjes. Ngjashëm, departamenteve të emergjencës poashtu i duhet më shumë kohë për të arritur deri në disa lokacione të caktuara rurale dhe kushtet në qendrat e emergjencës janë më të kufizuara në nivelin lokal (më periferik). Rrjedhimisht, çdo rast i lëndimeve më të rënda duhet trajtuar në qendrat rajonale, larg nga këto lokacione periferike, dhe kjo gjendje kontribuon në pasigurinë dhe pakënaqësinë e përgjithshme, që zakonisht i shpie njerëzit që të ndjehen më pak të sigurt pasi që, për shembull, mund të ndodhë që nuk do të arrijnë më kohë në spital.

Figura 10 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin Tuaj?


Kur krahasohen rezultatet mes perceptimeve të sigurisë në zonat urbane dhe rurale në nivel të lagjes gjer në fund të vitit 2014, vërehet se respondentët nga zonat rurale ndjehen pak më të sigurtë në lagjen e tyre sesa ata nga zonat urbane. Respondentët nga zonat rurale kanë konfirmuar se ata kryesisht e njohin njëri-tjetrin dhe e perceptojnë lagjen e tyre si një vend të sigurt për të jetuar. Mirëpo, me 2015 rezultatet janë kryesisht më pozitive dhe nuk ka dallim në perceptime mes respondentëve nga zonat rurale dhe urbane.

Figura 11 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Lagje?



Ngjashëm si në rastin e lagjes, kur respondentët nga zonat e ndryshme u pyetën mbi sigurinë e perceptuar në shtëpinë/apartamentin e tyre, dallimi më i madh u shënuar në vitin 2013. Ndonëse nuk është ndonjë hendek i konsiderueshëm, qytetarët që jetojnë në zona urbane janë ndjerë kryesisht më pak të sigurt në krahasim me ata që jetojnë në zona rurale. Në dy vitet në vijim, siç shihet në figurën e mëposhtme, nuk është shënuar ndonjë ndryshim i madh.

Figura 12 – Zona: Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpi/Apartament?




3.3. Analiza e perceptimeve të qytetarëve mbi sigurinë publike sipas përkatësisë etnike

Shikuar nga pikëpamja e përkatësisë etnike, vërehet se komunitetet e tjera që jetojnë në Kosovë, si: turqit, boshnjakët, si dhe komunitetet romë, ashkali dhe egjiptas (RAE), ndjehen kryesisht më të sigurt në Kosovë në krahasim me komunitetet shqiptare dhe serbe. Nga këndvështrimi i kornizës ligjore, Kosova siguron të drejta të një brezi të gjerë për pakicat e saj. Ka raste të diskriminimit, po kur jemi te sektori publik, të drejtat e pakicave zakonisht zbatohen shumë më mirë dhe ka trajtim preferencial, posaçërisht në nivelin qendror/kombëtar. Kjo mund të ketë ndikuar në ndjenjën e tyre të përgjithshme të sigurisë. Sidoqoftë, kur krahasohen të dhënat gjatë katër viteve të mbuluara nga ky raport, vërehet një trend i rënies së ndenjës së sigurisë në radhët e këtyre komuniteteve.

Nga ana tjetër, shqiptarët e Kosovës kanë realizuar trend pozitiv, ku numrat janë rritur për së paku 10 pikë përqindje çdo vit, duke rezultuar nga 24 përqind të tyre që janë ndjerë të sigurt më 2012 në 54 përqind më 2015. Kur shikohen numrat e serbëve të Kosovës, vërehet se ky komunitet është ai që ndjehet më pak i sigurt në Kosovë. Ndonëse, kur krahasohen numrat nga 2012, ashtu si në rastin e shqiptarëve të Kosovës, vërehet një trend pak pozitiv. Numri i serbëve të Kosovës që janë ndjerë kryesisht të pasigurt ka rënë nga 69 përqind me 2012 në 28 përqind më 2015. Mirëpo, ia vlen të përmendet se përqindja e atyre që janë ndjerë të pasigurt është shpërndarë ndërmjet atyre që ndjehen të sigurt në një shkallë mesatare pa ndryshime madhore në numrat e atyre që ndjehen kryesisht të sigurt në Kosovë. Kjo tregon një rënie në pasigurinë e perceptuar të serbëve të Kosovës, por jo domosdoshmërisht rritje në ndjenjën e sigurisë.


Figura 13 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Kosovë (niveli kombëtar)?



Respondentët e të gjitha përkatësive etnike ndjehen më të sigurt në fshatrat dhe/ apo qytetet e tyre përkatëse. Kur kemi të bëjmë me sigurinë e tyre personale në


fshat apo qytet, janë vërejtur trende pozitive në radhët e shqiptarëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë. Megjithëse më 2013 serbët e Kosovës ishin ata që ndjeheshin më të sigurt në fshatin e tyre, në dy vitet e fundit në radhët e këtij komuniteti ka mbizotëruar një trend pak më negativ.

Figura 14 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Fshatin/Qytetin tuaj?




Rezultate të ngjashme janë shënuar kur nga respondentët është kërkuar të vlerësojnë shkallën gjer në të cilën ata ndjehen të sigurt në lagjen e tyre. Trende pozitive janë vërejtur si në mesin e shqiptarëve të Kosovës ashtu edhe në mesin e komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë, gjersa një trend pak më negativ vazhdon në mesin e serbëve të Kosovës. Kjo ndjesi e pasigurisë në radhët e serbëve të Kosovës ndërlidhet kryesisht me faktin se besimi i tyre ndaj institucioneve të shtetit të Kosovës, duke përfshirë institucionet e sigurisë, është mjaft i ulët në krahasim me komunitetet e tjera që jetojnë në Kosovë.

Figura 15 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Lagje?



Në përgjithësi, qytetarët nga të gjitha komunitetet ndjehen më të sigurt në shtëpitë (shtëpi/apartament) e tyre në krahasim me pjesët e tjera të Kosovës. Ky trend është pozitiv në rastin e shqiptarëve të Kosovës. Perceptime të ngjashme janë shënuar në radhët e serbëve të Kosovës dhe pakicave tjera që jetojnë në Kosovë. Ndonëse, rezultatet janë mjaft pozitive, dhe mesatarisht 74 përqind e serbëve të Kosovës dhe 76 përqind e pakicave tjera ndjehen të sigurt, nuk ka ndonjë trend të palëkundur pozitiv siç është rasti me shqiptarët e Kosovës. Një prej shpjegimeve ndërlidhet me besimin pak më të rritur gjatë viteve ndaj institucioneve të sigurisë në radhët e shqiptarëve të Kosovës, gjersa nuk janë shënuar ndryshime madhore në radhët e komuniteteve tjera që jetojnë në Kosovë, veçanërisht në mesin e serbëve të Kosovës. Një tregues tjetër poashtu me rëndësi është zvogëlimi i numrit të vrasjeve. Nëse krahasojmë vrasjet nga viti 2000, është evidente se nga 256 vrasje të kryera në vitin 2000, numrat janë zvogëluar nga viti në vit, duke rënë në 35 gjatë vitit 2014.

Figura 16 – Përkatësia etnike: Sa të sigurt ndjeheni në Shtëpi/Apartament?



4. ÇËSH TJET KRYESORE TË SIGURISË PUBLIKE NË KOSOVË

Gjetjet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të kufizuara mbi konceptin e sigurisë publike. Siguria publike ka të bëjë me çështjet e sigurisë brenda një vendi dhe veprimet e qeverisë për të siguruar mbrojtje për qytetarët, institucionet dhe organizatat nga kërcënimet potenciale ndaj mirëqenies së tyre dhe prosperitetit të komuniteteve të tyre.³ Këto rreziqe dhe kërcënime kryesisht bazohen në rrezikun e shkaktuar nga faktori njeri, por nuk kufizohen në fatkeqësi natyrore. Nga ana tjetër, siguria kombëtare është objekt i interpretimeve më të gjera, duke iu referuar kërcënimeve dhe rreziqeve të brendshme dhe veçanërisht atyre të jashtme që rrezikojnë sigurinë shtetërore dhe kërkojnë bashkëpunim me shtetet tjera në luftën kundër rreziqeve dhe kërcënimeve globale. Sipas shumicës së respondentëve vërehet se rreziqet dhe kërcënimet kryesore ndërlidhen me ato të shkaktuara nga faktori njeri. Ndonëse Kosova nuk përjashtohet nga fatkeqësitë natyrore dhe çdo vit rreziqet e kësaj natyre janë të pranishme në pjesë të ndryshme të territorit, qytetarët nuk duket të jenë shumë të brengosur lidhur me këto lloje të rreziqeve dhe sfidave. Nga ana tjetër, çështjet lidhur me rreziqet e shkaktuara nga faktori njeri siç janë plaçkitjet dhe aksidentet e trafikut, si dhe rreziku nga kafshët endacake e shkeljet e ngjashme duket se shkaktajnë shkallë të lartë të shqetësimit në mesin e qytetarëve të Kosovës. Të dhënat e paraqitura mëposhtë i referohen të dhënave statistikore të mbledhura në tri vitet e fundit (2013-2015), edhe pse ne nuk e kemi matur opinionin publik mbi kafshët endacake në vitin 2012.

Kafshët endacake dalin si çështje shumë serioze për shumicën e repondentëve më 2014 dhe 2015. Shumica e respondentëve (respektivisht 51 dhe 53 përqind) i perceptojnë kafshët endacake si një nga rreziqet më të mëdha të sigurisë. Kjo për shkak të disa rasteve të sulmeve nga kafshët endacake (kryesisht qen endacak) veçanërisht ndaj individëve të ndjeshëm, rrjedhimisht në përgjithësi fëmijë dhe gjenerata më të reja. Nuk janë përjashtuar rastet me fatalitet. Rastet e sulmeve nga kafshët janë më të shprehura në stinën e vjeshtës dhe dimrit posaçërisht, dhe gjatë orëve të mëngjesit dhe mbrëmjes. Gjer tani, janë ndërmarrë hapa tejet të kufizuar në trajtimin e kafshëve endacake. Në Prishtinë, më 2015, u bë pastrimi i disa deponive dhe u rrënuan disa shtëpi të vjetra të cilat ishin evidentuar si rrezik për shëndetin publik dhe të cilat kishin joshur qentë endacakë për shkak të mbeturinave që ishin grumbulluar aty.⁴ Ka pasur disa ankesa nga qytetarët e komunave të ndryshme të cilët ndjehen të kërcënuar nga numri i madh i qenve endacakë.⁵ Deri tani, nuk janë ndërmarrë hapa konkret të cilët do të kontribuonin në gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme në nivel kombëtar për problemin e diskutuar mësipër. Çështja nuk është trajtuar si duhet në nivel lokal,

3 Rothbard, Murray, N., For a New Liberty: The Libertarian Manifesto, Ludwig von Mises Institute, 2006

4 Koha, 2015, vegëza: <http://koha.net/?id=8&l=78939>

5 Zëri, 2015, vegëza: <http://zeri.info/kronika/36178/qente-endacake-mesyjne-drenasin/>

kryesisht për shkak të mungesës së kapaciteteve (veçanërisht financiare) për t'u marrë me këtë punë.


Aksidentet në trafik paraqesin një çështje tjetër shumë shqetësuese për 42 përqind të respondentëve në vitin 2012, 49 përqind të respondentëve me 2014 dhe 47 përqind me 2015. Ka të dhëna që tregojnë se numri i aksidenteve të trafikut në Ballkan, përfshirë Kosovën, është tri herë më i lartë sesa në vendet e tjera evropiane.⁶ Bazuar në katër vitet e kaluara, mesatarisht çdo vit kanë ndodhur rreth 17,700 (15,200 në 14 vitet e fundit) aksidente trafiku, dhe rreth 10,000 persona janë lënduar, gjersa më shumë se 120 persona kanë humbur jetën në aksidente trafiku.⁷ Kur shikohen numrat nga viti 2002, numri i aksidenteve është dyfishuar dhe numri i njerëzve që kanë vdekur në aksidente trafiku mbetet i lartë dhe asnjëherë nuk ka rënë nën 120. Mirëpo, në katër vitet e fundit, është shënuar një rënie e vogël në numrin e aksidenteve por numri i vdekjeve në aksidente trafiku mbetet i lartë dhe vazhdon të rritet.

Shkaqet më të shpeshta të aksidenteve të trafikut janë numri i shtuar i automjeteve në rrugët kryesore, ngasja e shpejtë, dhe mosrespektimi i rregullave të trafikut, si nga ngasësit ashtu edhe nga këmbësorët. Gjithashtu, shkaqet e tjera që ndikojnë në aksidentet e trafikut janë mosmbajtja e distancës së sigurisë, gjendja teknike e automjeteve, mungesa e kontrollit teknik të automjeteve, gjendja e keqe e rrugëve (posaçërisht mirëmbajtja e dobët gjatë temperaturave të ulëta), mungesa e shenjave të trafikut, që shpesh dëmtohen ose vjedhen. Rëndësi e posaçme duhet t'i kushtohet mbikëqyrjes së procesit të pajisjes me patentë shoferi, në veçanti kur kemi të bëjmë me zotësitë mjekësore dhe psiko-fizike.

Në tri vitet e fundit, respondentët nga rajoni i Prishtinës, Mitrovicës dhe Pejës me nga të paktën 44 përqind në secilin, janë më të brengosur për aksidentet e trafikut në krahasim me rajonet tjera. Plaçkitjet paraqesin shqetësim serioz për respondentët që vijnë nga rajoni i Gjakovës dhe Ferizajit, vijuar nga Prishtina dhe Prizreni. Incidentet e dhunshme janë brengosëse për respondentët nga Mitrovica dhe Gjilani, që të dyja këto rajone të banuara nga një numër më i madh i pakicës serbe në krahasim me rajonet tjera. Ngjashëm, të dyja këto rajone shtrihen përgjatë vijës kufitare me Serbinë dhe mund të ndjehen pak më shumë të kërcënuara në rast të luftimeve apo incidenteve të dhunshme potenciale ndëretnike, rrjedhimisht duke mos qenë të kufizuar në baza ndëretnike.

6 Koha, 2015, vegëza: <http://koha.net/?id=27&l=45871>

7 Të dhëna nga Policia e Kosovës mbi aksidentet në trafik

Figura 17 – Shqetësimet kryesore lidhur me sigurinë nga viti 2013 deri në vitin 2015

Ju lutemi vini re: Nuk ka të dhëna statistikore mbi perceptimet e qytetarëve mbi kafshët endacake nga viti 2013

Plaçkitjet paraqesin rrezikun e tretë për nga lartësia në radhitje sipas 32 përqind të respondentëve më 2012, 47 përqind të respondentëve më 2014 dhe 37 përqind të tyre më 2015. Shumica e respondentëve kanë shprehur shqetësimet e tyre përkitazi me vjedhjet e shpeshta që ndodhin në komunitetet e tyre. Disa nga arsyet kryesore për plaçkitjet e vazhdueshme, sipas respondentëve, mbesin situata e rëndë ekonomike, shkalla e lartë e papunësisë dhe varfëria e madhe. Nga raportet policore shihet se në dy vitet e fundit, mesatarisht, janë raportuar 6,980 raste të vjedheve.⁸ Nga ana tjetër, shumica e respondentëve konfirmojnë se kapacitetet e institucioneve për zbatimin e ligjit në luftimin e këtyre llojeve të krimit janë mjaft të kufizuara. Respondentët kanë shprehur shqetësimin e tyre se situata e gjithmbarshme ekonomike në Kosovë është duke kontribuar në rritjen e krimeve të kësaj natyre.

Një çështje tjetër shqetësuese, ndonëse në një nivel më të ulët, janë fatkeqësitë natyrore të cilat janë të pranishme në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën. Edhe pse fatkeqësitë natyrore paraqesin çështje brengosëse në shkallë më të ulët, në krahasim me rreziqet e tjera të shkaktuara nga njeriu, këto shqetësime kryesisht kanë të bëjnë me zotësitë teknike, financiare, njerëzore dhe të tjera të institucioneve të Kosovës për të reaguar ndaj fatkeqësive natyrore.

Çështja më së paku shqetësuese për respondentët doli të jetë dhuna në familje. Ishin vetëm 3 përqind të respondentëve më 2013, 15 përqind më 2014 dhe 13 përqind më 2015, të cilët e perceptuan dhunën në familje si çështje serioze në komunitetin e tyre. Mirëpo, është e evidente që respondentët ngurruan të përgjegjen drejt kur u pyetën

⁸ Në vitin 2014 u shënuan 7,740 raste të vjedhjes, dhe 5,980 gjatë vitit 2015

mbi dhunën në familje si dhe mbi çështjet e tjera më të ndjeshme. Vërehet mungesa e përgjithshme e informatave mbi dhunën në familje dhe format e saj. Për më tepër, shumë lloje të formave të dhunës konsiderohen si “tradicionalisht të pranueshme”. Në masë të madhe, respondentët nuk e kuptojnë se dhuna në familje nuk përfshin vetëm keqtrajtimin fizik por edhe atë seksual, psikologjik, emocional dhe ekonomik. Prandaj, këto rezultate mund të mos jenë plotësisht përfaqësuese, veçanërisht duke marrë parasysh se vetëm të dhënat nga Policia e Kosovës tregojnë se janë më shumë se 1,000 raste të dhunës në familje që raportohen çdo vjet.⁹ Megjithatë, këto shifra janë të larta, duke marrë parasysh në përgjithësi ngurrimin në raportimin e dhunës në familje, pasi që shoqëria kosovare e konsideron si çështje të ndjeshme dhe të turpshme. Poashtu, mendësia e njëjtë mbizotëron edhe në radhët e autoriteteve, siç janë policia dhe sistemi gjyqësor, dhe për më tepër ata mund të mos kenë ofruar mbështetjen e duhur në disa raste ku viktimat kishin raportuar raste të këtij lloji të dhunës.¹⁰

5. OFRUESIT E SIGURISË

Edicionet e BKS të vitit 2012, 2013, 2014 dhe 2015 tregojnë rritje në besimin e publikut ndaj institucioneve të sigurisë në krahasim me gjyqësorin dhe institucionet tjera qendrore politike. Në mënyrë që të krijohet një perceptim më preciz ndaj ofruesve kryesor të sigurisë, respondentëve iu parashtruan pyetje të ndryshme me qëllim që të vlerësohet shkalla gjer në të cilën perceptimet e tyre bazohen në kontakte apo interaksione personale me institucionet e sigurisë, pra Policinë e Kosovës. Treguesit u vlerësuan kryesisht në vitin 2013, 2014 dhe 2015.


Të dhënat nga viti 2013, sugjerojnë që pothuajse çdo i dyti respondent (43 përqind) më përpara do të mbronte vetë sigurinë e vet dhe të familjes së vet, që nënkupton se ata do ta mbronin vetveten. Kjo tregon një shkallë kryesisht të lartë të mosbesimit ndaj efektivitetit të shtetit dhe insitucioneve shtetërore të sigurisë. Respondentët konsiderojnë se institucionet shtetërore, që nënkupton institucionet e sigurisë, drejtësisë si dhe ato qendrore, kanë dështuar në ndërtimin e një mjedisi të sigurt dhe në parandalimin efektiv të problemeve të ndryshme të sigurisë publike siç janë plaçkitjet, aksidentet e trafikut dhe krimet e tjera më të rënda. Përkundrazi, një e treta e respondentëve më përpara do t’i drejtoheshin Policisë së Kosovës sesa të mbrojnë vetveten dhe sigurinë e familjes së tyre. Vitin e njëjtë, respondentët pastaj u pyetën se cilit nga institucionet e sigurisë do t’ia raportonin një krim apo incident të dhunshëm,

9 Policia e Kosovës, Njësia për hetimin e krimeve të rënda, shifrat mbi dhunën në familje për vitet 2010, 2011, 2012, 2013

10 Telegrafi 2015, vegëza: <http://www.telegrafi.com/dhuna-ne-familje-krim-apo-tradite/>

dhe shumica dërrmuese (87 përqind) e tyre pohuan se do t'ia raportonin Policisë së Kosovës dhe 10 përqind e tyre ishin të ndarë mes raportimit tek aktorët ndërkombëtar të pranishëm në Kosovë dhe mosraportimit fare. Rezultate të ngjashme u shënuan në edicionin e vitit 2015 të BKS, ku shumica e respondentëve u deklaruan që ata do të kontaktonin policinë lidhur me çështje të sigurisë.¹¹ Është vërejtur që përgjegjet e tyre bazohen kryesisht në obligimin moral, që nënkupton se raportimi njëkohësisht mund të përdoret për të parandaluar krimet potenciale në të ardhmen.

Figura 18 – Arsyet e hezitimit të qytetarëve për të bashkëpunuar me policinë



Arsyet kryesore pse respondentët ndjehen të sigurt nuk ndërlidhen me mbrojtjen që ata e gëzojnë nga institucionet e sigurisë. Duke shqyrtuar të dhënat sasiore të mbledhura me 2013, del se një nga arsyet pse respondentët ndjehen të sigurt është fakti se ata jetojnë në lagje të mirë (52 përqind) vijuar nga fakti se ata çojnë jetë normale dhe respektojnë ligjin dhe rendin (35 përqind). Dy përgjegjet të cilat përmenden si arsye më e vogël se pse ata ndjehen të sigurt është zotësia për ta mbrojtur vetvetën (7 përqind) dhe vetëm 4 përqind të respondentëve patën thënë se ndjehen të sigurt ngase institucionet shtetërore të sigurisë e kryejnë mirë punën e tyre.

Duke marrë parasysh se ekziston një numër i njerëzve të ciltët nuk do t'ia raportonin policisë disa krime të caktuara, është me rëndësi të vlerësohet se cilat janë arsyet kryesore për ngurrimin e tyre për të bashkëpunuar me policinë. Duke shikuar rezultatet nga viti 2013 deri në vitin 2015, del se mbizotërojnë të njëjtat arsye dhe radhitja e tyre mbetet e njëjtë, që shpie te rritja e përqindjes secilin vit. Arsyet kryesore pse respondentët ngurrojnë për të raportuar kryesisht kanë të bëjnë me (i) frikën nga hakmarrja e kryesve (34 përqind), (ii) mosbesimin e përgjithshëm ndaj policisë (33 përqind) dhe faktin se (iii) policia tashmë e është ne dijeni për rastin (22 përqind). Numër më i ulët (5 përqind) i tyre kanë shprehur frikën nga aktorët politik dhe

11 Avdiu, P., Perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës, Shkurt 2016

institucionet e sigurisë dhe 5 përqind të mbetur kanë refuzuar të përgjegjen se pse do të përmbaheshin nga raportimi tek policia. Një element pozitiv është se barriera etnike nuk është parë si pengesë kur kemi të bëjmë me raportimin e krimit apo incidentit të dhunshëm tek organet e sigurisë. Opcioni i parë lidhet me faktin se qytetarët nuk besojnë se gëzojnë mbrojtje adekuatë të të dhënave të tyre personale që trajtohen nga policia. Sipas edicionit special të BKS për Mbrojtjen e të dhënave personale nga viti 2015, 34 përqind të respondentëve shprehën frikë nga keqpërdorimi potencial i të dhënave të tyre personale nga ana e policisë.¹² Këto rezultate tregojnë se ka dyshime dhe pasiguri sa i përket dhënies së informatave apo shpalosjes së të dhënave të tyre personale, dhe rrjedhimisht identitetit, nga ana e policisë palëve të treta.

Faktorët e njëjtë obstruktiv për bashkëpunim më të mirë mes qytetarëve dhe policisë duket që janë rritur në dy vitet vijuese, duke treguar kështu se edhe pse besimi i përgjithshëm ndaj institucioneve është rritur, respondentët ngurrojnë mjaft për të bashkëpunuar me policinë. Ndonëse, kontakti personal me policinë është rritur, është shqetësuese që edhe ngurrimi për të bashkëpunuar me policinë është rritur. Më 2014, 44 përqind të respondentëve frikësoheshin kryesisht nga shpalosja e identitetit, 42 përqind nuk mendonin se policia është efektive në luftimin e krimit dhe dukurive tjera negative dhe 37 përqind të tyre kishin frikë nga etiketimi si bashkëpunëtor nga ana e bashkëqytetarëve. Përkatesisht, më 2015 çështjet kryesore që parandalojnë qytetarët nga bashkëpunimi me policinë mbeten frika nga shpalosja e identitetit (56 përqind), pazotësia e policisë për të vepruar (49 përqind), dhe frika nga etiketimi si bashkëpunëtor nga bashkëqytetarët (47 përqind).¹³

Sa i përket respondentëve të cilët kanë pasur kontakt me Policinë e Kosovës, një numër i konsiderueshëm (86 përqind) i tyre më 2013 patën thënë se nuk kanë kërkuar ndihmë apo raportuar tek policia në gjashtë muajt e fundit, pjesa tjetër prej 14 përqind të cilët kishin kërkuar ndihmë kishin pasur përvoja të ndryshme dhe rrjedhimisht përshtypje të ndryshme mbi efektivitetin e policisë. Këto rezultate janë të ndara pak a shumë në mënyrë të barabartë në tri grupe. Janë 26 përqind të respondentëve të cilët ishin shumë të kënaqur me trajtimin e kërkesës së tyre, 38 përqind sosh ishin deri diku të kënaqur, gjersa 36 përqind të tyre nuk ishin fare të kënaqur me mënyrën se si ishte trajtuar kërkesa e tyre nga ana e policisë. Rezultatet sa i përket shpeshtësisë së kontaktit me policinë në vitin 2015 dallojnë, dhe shumica e respondentëve (58 përqind) thonë se kanë kontaktuar Policinë e Kosovës.¹⁴

Kur respondentët u pyetën nëse ata, apo ndonjë i afërm i tyre, i kishin dhënë ryshfet autoriteteve policore në gjashtë muajt e fundit, 97 përqind të respondentëve u përgjegjën se në të vërtetë nuk kishin dhënë. Prandaj, këto rezultate varen tërësisht

12 Kryeziu, S., Perceptimet për mbrojtjen e të dhënave personale, Janar 2015

13 Avdiu, P., Perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës, Shkurt 2016

14 Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i pestë, dhjetor 2015

nga shkalla e çiltërsisë së respondentëve dhe nuk mund të konsiderohen si vendimtare apo rezultate bindëse mbi situatën reale. Ngjashëm, më 2015, 95 përqind të respondentëve të cilët pohuan të kenë pasur kontakt me policinë, thanë se prej tyre asnjëherë nuk janë kërkuar para, dhurata apo ndonjë tjetër lloj ryshfeti nga ana e policëve.¹⁵ Një pjesë tjetër prej 2 përqind pranuan t'i kenë dhënë policëve dhurata apo para, dhe pjesa tjetër kishin paguar dreka/darka apo kishin dhënë premtim për ta kthyer favorin.¹⁶

Nga respondentët poashtu u kërkuar që të vlerësojnë nëse institucionet e sigurisë në Kosovë ishin të zonjat për të ofruar siguri në përgjithësi. Më 2014, me shumë se gjysma e respondentëve (57 përqind) mendonin se institucionet e sigurisë siç është Policia, FSK, Inteligjenca dhe Emergjencia Civile kishin nevojë për mbështetje të mëtejme nga bashkësia ndërkombëtare në mënyrë që të rriten tutje kapacitetet e tyre në ofrimin e sigurisë. Një pjesë tjetër prej 30 përqind të respondentëve kishin perceptimin se kapacitetet e këtyre institucioneve ishin realizuar në tërësi dhe nuk ka nevojë për mbështetje të mëtejme. Ky grup i respondentëve konsideronte se institucionet e sigurisë posedojnë zotësitë e kërkuara për të kryer detyrat e tyre, por se do të duhej të përqendrojnë përpjekjet e tyre duke u angazhuar për të luftuar krimet e ndryshme dhe kontribuar në sigurinë publike. Një pjesë tjetër prej 11 përqind të respondentëve nuk i perceptonin institucionet e Kosovës si të zonjat për të ofruar siguri. Këto perceptime bazohen në efektivitetin e kufizuar të gjithmbarshëm të këtyre institucioneve në luftimin e krimeve të ndryshme përgjatë viteve. Rezultatet e anketës së BKS që mbulon vitin 2015, tregojnë se nuk ka përkrahje për prani të pakufizuar të misioneve ndërkombëtare në Kosovë. Më saktësisht, shumica e repondentëve besojnë se misioni KFOR do të duhej të largohet nga Kosova brenda 3-5 vitesh, gjersa në rastin e EULEX, shumica e respondentëve janë përgjegjur se ky mision do të duhej të kishte përfunduar gjer tani.

15 Avdiu, P., Perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës, Shkurt 2016

16 Ibid

6. PËRMIRËSIMI I SIGURISË PUBLIKE

Duke marrë parasysh se siguria publike në Kosovë ka marrë një perceptim në përgjithësi mesatar, QKSS ka vlerësuar masat të cilat qytetarët i kanë perceptuar si më të rëndësishmet për nga kontributi për përmirësimin e sigurisë së tyre publike. Shumica e respondentëve pajtohen që çështjet e para që duhen adresuar janë ato që kanë të bëjnë me sektorin arsimor dhe ekonomik.

Sipas shumicës së respondentëve gjatë viteve (94 përqind më 2012, 96 përqind më 2014 dhe 97 përqind më 2015) ekziston një nevojë e ngutshme për ta ngritur dhe zhvilluar tutje sistemin arsimor i cili për momentin është mjaft i dobët. Kjo masë vijohet tutje nga nevoja për të rritur mundësitë (mesatarisht 94 përqind në tri vitet) për rininë në aktivitete kulturore, sportive dhe të tjera, të cilat sipas shumicës së respondentëve janë mjaft të kufizuara. Respondentët pajtohen që rritja e ofrimit të aktiviteteve të tilla do t'i ndihmonte gjeneratat e reja në zhvillimin e shkathtësive të tyre shoqërore, disiplinës e zotësive të tjera. Kjo do të zvogëlonte tutje mundësitë që të rinjtë të përfundojnë në aktivitete që ndërlidhen me krimin siç janë thyerjet e vjedhjet, abuzimin i drogave dhe alkoolit, apo edhe sjellje të tjera të pahijshme të cilat kontribuojnë në mungesën e sigurisë së perceptuar.

Një çështje tjetër shumë shqetësuese për shumicën e respondentëve është situata e gjithmbarshme ekonomike në Kosovë. Respondentët në përgjithësi e perceptojnë situatën ekonomike në Kosovë si mjaft të pazhvilluar duke çuar kështu në papunësi të lartë, të ardhura të ulëta dhe shkallë të lartë të varfërisë. Kjo është një nga çështjet serioze të cilat duhen marrë parasysh ngase ajo poashtu ka ndikim në shkallën e lartë të krimeve të ndryshme, për shembull ato që kanë të bëjnë me vjedhjet. Bazuar në shkallën e lartë të varfërisë që e karakterizon Kosovën, 79 përqind e respondentëve më 2012, 89 përqind më 2014 dhe 92 përqind më 2015 pajtohen se ka nevojë për rritje të ndihmës sociale për ato ekonomi familjare të cilat nuk mund t'i përmbushin kërkesat themelore për të fituar mjaftueshëm për standarde themelore të jetesës. Nevoja për përmirësim të zhvillimit ekonomik është shumë e rëndësishme dhe urgjente për 97 përqind të respondentëve nga viti 2014, dhe 98 përqind sosh nga viti 2015. Situata ekonomike dhe papunësia e lartë në Kosovë shihet si një nga kërcënimet dhe rreziqet kryesore në Kosovë.¹⁷ Respondentët janë shprehur të shqetësuar se situata ekonomike në Kosovë dhe shkalla e lartë e papunësisë, sidomos në radhët e të rinjve, paraqesin faktorë të dëmshëm për tërë sigurinë dhe stabilitetin e brendshëm në Kosovë.


Shikuar nga pikëpamja e sigurisë, respondentët e perceptojnë si shumë të rëndësishme dhe domosdoshme rritjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe policisë. Ndonëse besimi ndaj Policisë së Kosovës nuk është aq i lartë sa ai ndaj disa

¹⁷ Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i pestë, dhjetor 2015

institucioneve tjera të sigurisë, qoftë në nivel kombëtar – Forca e Sigurisë së Kosovës, zjarrfikësit, apo prania e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë – KFOR. Sidoqoftë, 87 përqind të respondentëve më 2012 duket se e kishin perceptuar si shumë me rëndësi vendosjen dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes qytetarëve dhe policisë. Ata argumentonin se bashkëpunimi mes qytetarëve dhe policisë është i kufizuar. Kjo mund të jetë si rezultat i kënaqshmërisë mesatare me punën e PK. Në edicionin e BKS nga viti 2012, dalin vetëm 42 përqind të respondentëve të cilët janë të kënaqur me punën e PK.¹⁸ Kjo përqindje u rrit më 2014 dhe 2015, kur 95 përqind të respondentëve e konsiderojnë bashkëpunimin mes policisë dhe qytetarëve si faktor të rëndësishëm në zvogëlimin e numrit të krimeve dhe përmirësimin e sigurisë publike në Kosovë.

Nga ana tjetër, shumica e qytetarëve nuk e perceptojnë se ekziston nevoja për të rritur dënimet e shqiptuara nga ana e gjykatave, pasi që shumica prej tyre pohonin se masat e tilla tashmë ekzistojnë. Ndonëse më 2012 ishin 57 përqind, 65 përqind më 2014 dhe 58 përqind më 2015, të respondentëve të cilët u përcaktuan për nevojën për të rritur ndëshkimet e shqiptuara nga gjykatat, arsyeja kryesore dhe çështja e vërtetë në këtë kuptim, sipas tyre, ka të bëjë me faktin se sistemi i drejtësisë nuk është funksional dhe si rezultat është vështirë të zvogëlohen dhe luftohen shkeljet dhe llojet e ndryshme të krimeve.

Figura 19 – Masat për përmirësimin e sigurisë publike



Ju lutemi vini re: Nuk ka të dhëna të disponueshme statistikore mbi opinionin publik për vitin 2013, as të dhëna mbi perceptimet lidhur me zhvillimin ekonomik për vitin 2012

18 Barometri Kosovar i Sigurisë, Edicioni i parë, dhjetor 2012

Kur krahasohen rastet ndërmjet gjinive numrat mbi masat e njëjta që duhen ndërmarrë, i vetmi dallim është se gratë në përgjithësi i shohin të njëjtat masa për 2 deri 7 pikë përqindjeje si më të nevojshme në krahasim me respondentët burra. Tek krahasimi i perceptimeve të respondentëve sipas zonës, vërehen dallime minore. Respondentët që jetojnë në zonat rurale e shohin si më të nevojshme rritjen e numrit të policëve në rrugë në krahasim me respondentët nga zonat urbane. Poashtu, duke marrë parasysh se ata që jetojnë në zona rurale mesatarisht kanë standard më të ulët të jetesës, ata do të jenë më të prirur të mendojnë, në krahasim me ata që jetojnë në zona urbane, se ka nevojë që të rritet ndihma sociale për njerëzit të cilët nuk i kanë kushtet elementare për jetë. Nuk janë vërejtur dallime madhore gjatë krahasimit të rezultateve mes etniteteve që jetojnë në Kosovë, të gjithë pajtohen njëzëri se masat e lartpërmendura janë të rëndësishme vendimtare për përmirësimin sistematik të sigurisë publike përshtatshëm për të gjithë qytetarët e Kosovës.

PUNIMET E CITUARA

Baza e të dhënave të anketimeve, nga katër edicionet e Barometrit Kosovar të Sigurisë, të realizuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë gjatë periudhës së viteve 2012 – 2014.

Gjashtë fokus grupe me anketuesit e terrenit të Barometrit Kosovar të Sigurisë, organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë pas kryerjes së anketimeve në terren.

Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i pestë (Dhjetor 2015) Vegëza: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer - Fifth Edition 523670.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fifth_Edition_523670.pdf), Qasur më: 10 mars 2016

Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i katërt (Dhjetor 2014) Vegëza: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer - Fourth Edition 383440.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_-_Fourth_Edition_383440.pdf), Qasur më: 12 mars 2016

Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i tretë (Dhjetor 2013) Vegëza: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer Third Edition 20786.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_Third_Edition_20786.pdf), Qasur më: 11 mars 2016

Barometri Kosovar i Sigurisë, Zërat e Kosovës, Vështrimet dhe Perceptimet, (Maj 2013) Vegëza: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer-The voices of Kosovo Insights and Perceptions 199745.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer-The_voices_of_Kosovo_Insights_and_Perceptions_199745.pdf), Qasur më: 13 mars 2016

Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i parë (Dhjetor 2012) Vegëza: [http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer Report English 152996.pdf](http://www.qkss.org/repository/docs/Kosovo_Security_Barometer_Report_English_152996.pdf), Qasur më: 10 mars 2016

Rothbard, Murray, N., (2006) For a New Liberty: The Libertarian Manifesto, Ludwig von Mises Institute

Koha Net. (Tetor 2015), Vjeshta e Dimri këcënojnë me qentë endacak, marrë më 13 mars 2016, në: <http://koha.net/?id=8&l=78939>

Zeri, (Qershor 2015) Qentë endacak mësyjnë Drenasin, marrë më 13 mars 2016, në: <http://zeri.info/kronika/36178/qente-endacake-mesyjne-drenasin/>

Koha Net., (Shkurt 2015), Në Ballkan nga aksidente rrugore çdo vit humbin jetën rreth 1.700 persona, marrë më 13 mars 2016, në: <http://koha.net/?id=27&l=45871>

Telegrafi, (2015), Dhuna në familje, krim apo traditë?, marrë më 15 mars 2016, në: <http://www.telegrafi.com/dhuna-ne-familje-krim-apo-tradite/>

Evropa e Lirë (2016), Vjedhjet, fenomen shqetësues në Kosovë, marrë më 15 mars 2016, në: <http://www.evropaelire.org/a/27648650.html>

PUBLIKIMET E MËPARSHME TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË

[Perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës, Shkurt 2016](#)

[Perceptimet e publikut për politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë, Shkurt 2016](#)

[Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i pestë, Dhjetor 2015](#)

[Trendet e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë - Periudha: 2012-2015, Shtator 2015](#)

[Perceptimet e Qytetarëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Janar 2015](#)

[Perceptimet e publikut për politikën e jashtme dhe dialogun me Serbinë, Janar 2015](#)

[Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i katërt, Dhjetor 2014](#)

[Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i tretë, Dhjetor 2013](#)

[Barometri Rajonal i Sigurisë, Dhjetor 2013](#)

[Barometri Kosovar i Sigurisë – Zërat e Kosovës: vështrimet dhe perceptimet, Maj 2013](#)

[Barometri Kosovar i Sigurisë – Edicioni i parë, Dhjetor 2012](#)

PUBLIKIMI I RADHËS I BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË

[Perceptimet publike mbi ekstremizmin, Maj 2016](#)

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)(048)

Barometri Kosovar i Sigurisë: Siguria Publike në Kosovë : Trendet në perceptimin e qytetarëve mbi sigurinë publike në Kosovë/Sofje Kryeziu. – Edicion special. – Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2016. - 32 f.; ilustr. me ngjyra; 30 cm.

1. Kryeziu, Sofije

ISBN 978-9951-679-40-4

ISBN 978-9951-679-40-4



9 789951 679404

www.qkss.org